



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skup tina Assembly

Legjislatura e V-të

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 25/15

Prishtinë, më 01.07.2015, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Naser Osmani, Safete Hadergjonaj, Jelena Bontić, Latif Gashi, Labinotë Demi-Murtezi, Besa Gaxherri, Ilir Deda dhe Fikrim Damka.

Munguan: Bardhyl Meta, Bali Muharremaj dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës të ftuar: Agim Krasniqi Zv. Ministër, Ekrem Hysenaj Zv. Drejtor nga ATK, Sami Salihu
Menaxher i lartë nga ATK, Ruzhdi Zenelaj ekspert nga GIZ.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Rejhane Zylfijaj dhe Ramadan Ismaili nga GIZ, monitorues nga shoqëria civile, gazetar.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli dhe Merita Zogjani (Praktikante).

Mbledhjen e kryesoi: Naser Osmani, Kryetari i Komisionit.

1. **Miratimi i rendit të ditës**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.6.2015;**
3. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave;**
4. **Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale;**
5. **Shqyrtimi i Raportit i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar;**
6. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetari propozoj që të plotësohet rendi i ditës me një pikë të re, si pika e 6 me radhë: Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2015. Ky propozim vë pas konsultimeve me Ministrinë e Financave, që si rezultat i marrëveshjes që pritet të nënshkruhet me Fondin Monetar Ndërkombëtar, ku miratimi i rishikimit të buxhetit është një ndër pikat e marrëveshjes që duhet të miratohet në Kuvend më së voni deri më 17

Korrik, duke marr parasysh se më 25 korrik mbahet mbledhja e FMN-së në Washington. Pas ndryshimit dhe plotësimit Kryetari konstaton se komisioni njëzëri miratoi rendin e ditës, me plotësime: shtohet pika e gjashtë me radhë Shqyrtimi në parim i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit nr. 05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës 2015

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 17.6.2015

Kryetari konstaton se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

Kryetari Projektligji për tatimin në të ardhurat e korporatave është shqyrtuar nga Grupi Punues. Gjatë takimeve janë marrë trajtuar të gjitha komentet dhe niveli i diskutimeve ka qenë profesional. Sa i përket amendamenteve të propozuara, në amendamentin 1 hiqet fjala Religjion, dhe në vend të saj është dhënë përkufizimi për Bankën Qendrore të Kosovës. Amendamenti 2 përkufizimi Religjion i pranueshëm, është ndryshuar dhe përshtatur me Ligjin për Lirinë Fetare. Amendamenti 3 hiqet përkufizimi Kosovë sepse është dika që dihet dhe nuk ka nevojë për përkufizim gjithashtu, rirenditen përkufizimet. Amendamenti 4 hiqet fjala tërësor si e tepërt. Amendamenti 5 hiqet fjala Një sepse është e tepërt. Në Amendamentin 6 dhe 7 riformulohet terminologjia. Amendamenti 8 ndryshohet terminologjia për të qenë në përputhje me Ligjin për Liritë Fetare. Amendamenti 9 fshihen fjalët duke përfshirë UNMIK-un sepse nuk është relevant për Ligjin në fjalë. Amendamenti 10 shtohet paragrafi 2 për të liruar dividendën nga tatimi.

Ekrem Hysenaj kërkesa nga ne dhe nga Ministri i Financave është që të rishqyrtohet edhe një herë kjo pikë për dividenta.

Kryetari e kemi diskutuar çështjen e dividendës gjatë dhe kemi arrit në përfundim që nuk ka kuptim të tatimohet dividenta për arsye se deri sa të arrihet te dividenta nënkupton se ka kaluar nëpër tatime, si dhe nuk ka kuptim të këtë tatim mbi tatim. Në Amendamentin 11 dhe 12 riformulohet nënparagrafi. Amendamenti 13 hiqet fjala është e domosdoshme dhe , në mënyrë që kostot e kompanive lidhur me ushqimet dhe transportin e punëtorëve të njihen si shpenzim i zbritshëm. Amendamenti 14 riformulohet terminologjia. Ndërkaq sa i përket amendamentit 15 propozoj që të ndryshohet me këtë tekst: shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënësi për një të punësuar në lidhje me punën, lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur. Amendamenti 16 riformulohet terminologjia. Amendamenti 17 është rregulluar gjuhësisht. Amendamenti 18 shtohet një paragrafi i ri. Në Amendamentin 19 dhe 20 riformulohet terminologjia. Amendamenti 21 ndahet paragrafi për shkak se ka qenë i gjatë. Amendamenti 22 hiqet fjala shërbimi . Në Amendamentin 23 është bërë emërimi i plot i ligjit që i referohet. Në Amendamentin 24 dhe 25 riformulohet terminologjia. Amendamenti 26 paragrafi 2 është ndarë, për shkak se ka qenë i gjatë. Në Amendamentin 27, 28, dhe 29 riformulohet terminologjia. Amendamenti 30 paragrafi 5 është ndarë për shkak se ka qenë i gjatë. Amendamenti 31 riformulohet terminologjia. Amendamenti 32 është ndryshuar dhe është rikthyer neni ashtu siç ka qenë në fuqi sa i përket shmangies së tatimit të dyfishtë.

Safete Hadergjonaj mirë është rregulluar çështja e tatimit të dyfishtë. Mirëpo a është në rregull që të kopjohet i njëjti nen në të dy ligjet? A është më mirë që në ligjin për korporata ti referohemi nenit 36 të ligjit për të ardhurat personale, apo duhet të jetë i njëjti tekst në të dy ligjet?

Ruzhdi Zenelaj sqaroi se nuk është në rregull të i referohet njërit ligj në ligjin tjetër, sepse ligji tjetër mund të amendamentohet dhe mund të mos jetë më referenca. Ligji për tatimin në të ardhurat e korporatave në parim e rregullon të njëjtën çështje por për persona të ndryshëm.

Kryetari Amendamenti 33 ndryshim terminologjie. Amendamenti 34 riformulohet terminologjia si dhe është shtuar pjesa e sigurimeve shëndetësore. Në Amendamentin 35 dhe 36 hiqet paragrafi në tërësi dhe rirenditën paragrafët. Në Amendamentin 37, 38, dhe 39 riformulohet terminologjia. Amendamenti 40 hiqet referenca. Amendamenti 41 është bërë zvogëlimi i periudhës së nxjerrjes së akteve nënligjore. Amendamenti 42 janë përcaktuar saktë ligjet që do të shfuqizohen me fillimin e zbatimit të këtij ligji. Amendamenti 43 riformulohet terminologjia. Amendamenti 44 ndryshohet neni të hyrja në fuqi dhe zbatimi.

Pas sqarimeve të amendamenteve të propozuara nga grupi punues, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për Projektligjin për tatimin në të ardhurat e korporatave, me ndryshimin e bërë në Amendamentin 15. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimin në të Ardhurat Personale

Ilir Deda në projektligj ka qenë fjala çmimi i transferit , ndërsa këtu është ndryshuar me transferimi i çmimeve , nuk e kam kuptuar ndryshimin?

Sami Salihu ky ndryshim është bërë në mënyrë që të bëhet një riformulim më i sakët në gjuhën shqipe.

Kryetari Amendamenti 1 riformulohet terminologjia. Amendamenti 2 ndryshohet për të qenë në pajtim me Ligjin për Lirinë Fetare në Kosovë. Amendamenti 3 riformulohet terminologjia. Amendamenti 4 fshihet fjala tërësor . Në Amendamentin 5 janë bërë përmirësime gjuhësore dhe teknike. Amendamenti 6 përkufizimi Kosovë , hiqet sepse është diçka që dihet dhe zëvendësohet me përkufizimin BQK. Amendamenti 7 shtohet nën përkufizimi i ri për FIFO. Amendamenti 8 është propozuar të hiqet dividenda nga tatimimi. Amendamenti 9 është bërë riformulim i referencës ligjore dhe ndryshimi tjetër është përmirësim teknik. Amendamenti 10, hiqet fjala UNMIK. Amendamenti 11 riformulohet terminologjia.

Ndërkaq Amendamenti 12 propozoj të ndryshohet me tekstin: lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur, dhe neni 8 paragrafi 3 nënparagrafi 1.18 hiqet. Në Amendamentin 13 është shtuar paragrafi i ri për ta liruar Dividentën, nga pagesa e tatimit. Amendamenti 14 ka përmirësim gjuhësor. Amendamenti 15 shtohet fjala dhe transportit . Amendamenti 16 ka përmirësim gjuhësor. Amendamenti 17 hiqet në tërësi nënparagrafi për të ju lejuar tatimpaguesve që ushqimi dhe transporti i punëtorëve të ju njihet e zbritshme. Në Amendamentin 18, 19, 20, dhe 21 riformulohet terminologjia. Amendamenti 22 hiqet teksti sepse është konsideruar i tepërt. Amendamenti 23 riformulohet terminologjia. Amendamenti 24 ka përmirësim gjuhësor dhe teknik. Amendamenti 25 shtohet paragrafi i ri. Në Amendamentin 26, 27, 28, dhe 29 riformulohet terminologjia. Amendamenti 30 thirret në emër të plotë të Ligjit. Amendamenti 31 riformulohet terminologjia. Amendamenti 32 ka përmirësim gjuhësor. Amendamenti 33 ndahet paragrafi në dy paragraf sepse ka qenë shumë i gjatë. Amendamenti 34 riformulohet terminologjia. Amendamenti 35 riformulohet paragrafi për të qenë në

pajtueshmëri me teknikën juridike të hartimit të legjislacionit. Amendamenti 36 riformulohet terminologjia. Amendamenti 37 ndryshohet teksti. Amendamenti 38 propozojë të ndryshohet me tekstin: shpenzimet e trajnimit të paguara nga një punëdhënës për një të punësuar, në lidhen me punën lejohen në tërësi në vitin në të cilin shpenzimet e tilla të trajnimit kanë ndodhur.

Në Amendamentin 39, 40, dhe 41 riformulohet terminologjia. Amendamenti 42 ndryshohet referenca. Amendamenti 43 dhe 44 riformulohet terminologjia. Amendamenti 45 i referohet referencave ligjore. Amendamenti 46 hiqen fjalët e tepërta. Amendamenti 47 dhe 48 riformulohet terminologjia. Amendamenti 49 hiqet neni tërësisht. Amendamenti 50 riformulohet emërtimi i kapitullit. Amendamenti 51 ka përmirësime teknike. Në Amendamentin 52, 53, dhe 54 riformulohet terminologjia. Amendamenti 55 hiqet neni në tërësi dhe bëhet rirenditja e neneve. Në Amendamentin 56, 57, dhe 58 riformulohet terminologjia. Amendamenti 59 hiqet teksti i pa nevojshëm. Amendamenti 60 riformulohet referenca ligjore. Amendamenti 61 hiqet referenca. Amendamenti 62 dhe 63 riformulohet terminologjia. Amendamenti 64 hiqet teksti. Në Amendamentin 65 është bërë ndryshim i neni. Në Amendamentin 66 janë përcaktuar saktë ligjet që do të shfuqizohen me fillimin e zbatimit të këtij ligji. Amendamenti 67 riformulohet terminologjia. Amendamenti 68 riformulohet neni.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni unanimisht nxori këtë:

Përfundim

Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për projektligjin për tatimin në të ardhurat personale me ndryshimin e bërë në Amendamenti 12 dhe amendamenti 38. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

5. Shqyrtimi i Raportit i Raportit me amendamente të Grupit Punues për Projektligjin për Tatimi mbi Vlerën e Shtuar

Kryetari Amendamenti 1 riformulohet terminologjia për të qenë më i kuptueshëm. Në Amendamentin 2 janë bërë përmirësime gjuhësore. Amendamenti 3 riformulohet terminologjia. Amendamenti 4 janë bërë përmirësime teknike dhe gjuhësor. Në Amendamentin 5 janë bërë përmirësime teknike. Amendamenti 6 rirenditen përkufizimet. Në Amendamentin 7 dhe 8 janë hequr shprehjet e tepërta. Në Amendamentin 9 dhe 10 riformulohet terminologjia. Amendamenti 11 është bërë përmirësim tek përkufizimi. Amendamenti 12 përkufizimi Kosovë është hequr, sepse është konsideruar si e panevojshme për faktin se është diçka e ditur si dhe e njëjta është zëvendësuar me përkufizimin e ri për Uzufruktin sepse nuk ka qenë dhe përmendet brenda në dispozitat e projektligjit. Amendamenti 13 ka përmirësime gjuhësore. Amendamenti 14 riformulohet titulli. Amendamenti 15 riformulohet terminologjia. Amendamenti 16 zëvendësohet paragrafi me tekst të ri. Në Amendamentin 17 deri 25 riformulohet terminologjia. Amendamenti 26 eliminohen dy fjalë. Në Amendamentin 27, 28, dhe 29 riformulohet terminologjia. Amendamenti 30 riformulohet neni. Amendamenti 31 propozimi i Deputetit Enver Hoti, nuk është përkrahur nga Grupi Punues për faktin se është konsideruar se Qeveria ka bërë ndryshimin e normave në përputhje me planin ekonomik qeveritar dhe Grupi Punues nuk ka tentuar që të bëjë ndryshime të cilat do të kishin efekt të madh buxhetor.

Ruzhdi Zenelaj amendamenti i Deputetit është kthim tërësisht i ligjit që ka qenë i aplikueshëm deri më sot dhe lidhet me kthimin e normës 16% siç ka qenë standard.

Ilir Deda sikur të ishte propozuar norma standarde 18% në mesin e normave 21% dhe 5% a kish me qenë më e pranueshme për Qeverinë?

Kryetari sikur të ishte propozuar norma 18% për mallra në vend të normës 21% nuk kishte pas nevojë për amendament, por është kërkuar norma 5% për mallrat e shportës, ndërsa ne e kemi 0%.

Kryetari - konstatoj se Komisioni unanimisht nuk përkrahur Amendamentin 1 të propozuar nga Deputeti Enver Hoti.

Kryetari - sqaroi se në Amendamentin 32 janë bërë rregullimet gjuhësore, Amendamenti 33 është propozuar të hiqet fjalia dhe me këtë ndryshim nuk iu është lënë mundësia Ministrit që me vendos norma tjera të TVSH-së, respektivisht të vendos norma të ulura deri në 5% dhe të ngritura deri në 22%, pasi që në bazë të Kushtetutës së Kosovës, e drejta e vendosjes së barrësë tatimore i takon Kuvendit të Kosovës. Amendamenti 34 janë bërë përmirësime gjuhësore dhe riformulohet terminologjia. Ndërkaq propozohet të shtohet edhe një amendament i ri 35, me tekstin si në vijim: në nenin 26, në nënparagrafin 2.2, në rreshtin e parë pas fjalës energji elektrike të shtohet fjalët përfshirë transmisionin dhe distribuimin . Përderisa tani e kemi TVSH-në e energjisë elektrike në 8% nuk mund të jetë transmisioni dhe shpërndarja në 16% për arsye se ATK do të këtë shumë vështirësi në rimbursimet, prandaj me këtë propozim-ndryshim, shpërndarja, transmisioni, dhe energjia në përgjithësi të zbritet në 8%.

Ekrem Hysenaj theksoi se Ministria e Financave ka një propozim që në nenin 27, të shtohet një nënparagraf i ri 1.20 furnizimi i shërbimeve të transportit publik të udhëtarëve dhe bagazhit të tyre me çmimet të rregulluara nga autoriteti kompetent i Kosovës..

Ruzhdi Zenelaj sipas nenit 23 paragrafi 2 i rregullores për kushtet dhe kriteret për ushtrimin e veprimtarisë çmimet aplikohen për të gjithë njëjtë që nga momenti i nisjes. Kjo nënkupton se çdo çmim i taksive ose i autobusëve publik është i rregulluar në bazë të një rregullore që e nxjerr Kuvendi Komunal.

Ekrem Hysenaj në këtë kategori nuk hynë ata që janë jashtë rregullimit të çmimeve nga organi kompetent por vetëm ata që çmimet i kanë të rregulluara.

Kryetari theksoi se kemi dy amendamente të reja të propozuara që do të radhiten sipas formës së rregullt të tyre.

Kryetari më tutje sqaroi se në amendamentin 37 është bërë rregullim i saktë i referencës ligjore. Amendamenti 38 ka shtim të fjalës. Amendamenti 39 dhe 40 riformulohet terminologjia. Në Amendamentin 41 janë bërë përmirësime gjuhësore. Në Amendamentin 42, 43, dhe 44 riformulohet terminologjia. Në Amendamentin 45 janë bërë përmirësime gjuhësore. Amendamenti 46 riformulohet terminologjia. Amendamenti 47 është riformuluar, në mënyrë që personi i tatueshëm të ketë të drejtë të kërkesës së kreditimit në secilin muaj por jo më shpesh se një herë në tre muaj pasi që ai të jetë në kreditim të vazhdueshëm për tre muaj me radhë. Pra tani detyrimi për kërkesë nuk lidhet me tremujor por me tre muaj radhazi cilitdo qofshin ato. Në Amendamentin 48 dhe 49 riformulohet terminologjia. Amendamenti 50 është bërë riformulim i terminologjisë për të qenë më i kuptueshëm, si dhe për të qenë në pajtueshmëri me direktivën e BE-së për TVSh e cila e ndalon kërkesën për nënshkrim të faturës. Amendamenti 51 riformulohet terminologjia dhe përmirësimet gjuhësisht. Në Amendamentin 52 është eliminuar terminologjia e huaj. Amendamenti 53 propozimi i Deputeti Enver Hoti, nuk është përkrahur nga Grupi Punues.

Kryetari konstatoj se Komisioni unanimisht nuk përkrahu Amendamenti 2 të deputetit Enver Hoti.

Në Amendamentin 54 janë bërë përmirësime teknike dhe gjuhësore. Në Amendamentin 55 është hequr shkurtesa. Në Amendamentin 56 janë fshirë nënparagrafet. Në Amendamentin 57 janë hequr dispozitat të karakterit jorregullues. Amendamenti 58 anulohet paragrafi. Ky paragraf ka qenë në kundërshtim me parimet e ligjeve për faktin se nëse personi jo rezident kryen furnizime për personin rezident jo të

tatueshëm dhe nuk përcakton përfaqësues fiskal në Kosovë, ai paragrafë e ngarkon me tatime dhe ndëshkime personin rezident i cili blen nga ai. Përveç tjerash Ligji askund nuk ka vendos asnjë detyrim ndaj blerësit prandaj është e palogjikshme që blerësi si person jo i tatueshëm ti bart të gjitha pasojat. Amendamenti 59 amendament i propozuar nga deputeti Enver Hoti, pa përkrahjen e grupit punues.

Ruzhdi Zenelaj sqaroi se është vendosur pragu për TVSH-në në 30,000 dhe sipas praktikave ndërkombëtare. Deputeti ka kërkuar që kjo periudhë tremujore të vendoset por nuk ka bërë dallim në mes kategorive të bizneseve dhe për më tepër kjo mundësi i është lënë Ministrit që me Udhëzim Administrativ me kategorizu bizneset që munden me deklarue çdo 3 muaj ose 6 muaj.

Fikrim Damka në fillim është theksuar se janë bërë diskutime me Odat dhe me përfaqësuesit e interesit dhe e kamë vërejt që të gjitha komentet e tyre pothuajse janë të njëjta me amendamentet e Deputetit. Oda e biznesit kanë propozuar që pragu u TVSH-së të kthehet siç ka qenë 50,000 euro.

Kryetari sqaroi se gjatë diskutimeve janë marr në konsideratë të gjitha komentet e tyre mirëpo, kjo nuk nënkupton që çdo koment i diskutuar duhet domosdoshmërisht të gjitha të shëndrrohen në amendamente. Ne kemi diskutuar çështjen e pragut dhe kemi ardhur në përfundim se nuk mund të ndryshohet pasi që nuk është në pajtueshmëri me politika e qeverisë për reforma fiskale, që është edhe ndër qëllimet kryesore të projektligjit, por edhe forma siç është propozuar ndihmon në rregullimin e konkurrencës, sado që mund të ketë edhe anët negative.

Sami Salihu për ATK-në do të ketë komplikime të shumta. Procedurat janë të mëdha dhe të hyrat nuk janë në kohë.

Ruzhdi Zenelaj nëse kalon ky amendament duhet ta keni parasysh që duhet të ndryshohen edhe disa nene siç është kërkesa për rimbursim. Nëse Ministri e rregullon me akt nënligjor i rregullon edhe procedurat e rimbursimit për këtë kategori të veçantë edhe proceduar e deklarimit.

Kryetari konstaton se Komisioni unanimisht nuk përkrahu Amendamenti 3 të deputetit Enver Hoti.

Kryetari Amendamenti 60 është eliminuar një pjesë e tekstit që është konsideruar e panevojshme. Në amendamentin 61 kemi dy propozime. Propozimi i grupit punues, ku në nenin 57, nënparagrafin 1.2, janë shtuar fjalët për pasuri të paluajtshme, për të dhënë kuptim dispozitave që rregullohen me këtë nënparagraf e që ka të bëjë me mbajtjen e regjistrave dhe dokumenteve tjera të përcaktuar me këtë ligj, për një periudhë të caktuar kohore. Ndërsa propozimi i dytë është Amendamenti 4 i Deputeti Enver Hoti, që propozon që të hiqet periudha 20 vjeçare, sepse është e pakuptimtë dhe në kundërshtim edhe me ligjet tjera.

Ruzhdi Zenelaj sqaroi se amendamenti i grupit punues është pikërisht në linjë me ligjet tjera. Asetet e paluajtshme zhvlerësohen për 20 vite sipas ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave. Si mundesh me dëshmu para ATK-së që aset i është i yti nëse nuk e ki faturën? Kjo është arseja përse këtu kërkohet brenda 20 viteve të mbahen shënimet.

Kryetari konstaton se Komisioni unanimisht nuk përkrahu Amendamenti 4 të deputetit Enver Hoti.

Kryetari Amendamenti 62 riformulohet terminologjia. Amendamenti 63 janë përcaktuar saktë Ligjet. Amendamenti 64 është përcaktuar që hyrja në fuqi e këtij ligji, që konsiderojë se duhet ndryshuar dhe të bëhet me 1 shtator 2015. Amendamenti 65 janë përmirësuar referencat.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se Komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohen amendamentet e propozuara nga Grupi Punues për Projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar, me dy amendamente plotësuese Amendamenti 31 dhe 35, ndërsa nuk përkrahen 4 amendamentet e propozuara nga deputeti Enver Hoti. Raporti me amendamente procedohet për shqyrtim në komisionet tjera të përhershme.

6. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015

Kryetari cilat lëvizje dhe cilat ndryshime janë bërë me rishikimin e buxhetit 2015, kërkojmë që të na njoftojë zv. ministri i financave.

Agim Krasniqi të gjitha organizatat buxhetore kanë marrë udhëzimet për rishikim të buxhetit, ndërkohë i kemi pranuar kërkesat dhe janë trajtuar me kujdes brenda instruksioneve për rishikim. Në ndërkohë janë zhvilluar negociatat me FMN për një program të mundshëm dhe është arritur pajtueshmëri për programin. Një nga pikat e këtij programi është edhe rishikimi i buxhetit 2015 dhe propozimet janë bërë në këtë kontekst. Rishikimi merr parasysh të gjitha informatat për gjashtëmujorin e parë, janë marrë parasysh të gjitha ecuritë fiskale. Të hyrat buxhetore është parë se kanë qenë të mbivlerësuara në buxhetin fillestar ku edhe shpenzimet janë bërë mbështetur në këto të hyra. Janë marrë parasysh ndryshimet që do të ndodhin në politikën fiskale përmes miratimit të ligjeve që janë në procedurë dhe janë reflektuar në buxhetin e rishikuar. Sa i përket shpenzimeve, qeveria do të jetë e gatshme me i implementuar të gjitha projektet kapitale. Megjithatë, janë zvogëluar shpenzimet joproduktive për me pas kursime kryesisht në shpenzimet operative. Të hyrat e përgjithshme do të jenë 1,535 miliard euro. Ky parashikimi është më i ulët se buxheti fillestar për 52 milion euro. Krahasuar me vitin 2014 është një rritje prej 14%. Të hyrat reale nga ATK priten me qenë 340 milion euro, nga Dogana pritet me arrit shumën prej 964 milion euro. Kemi paraparë të hyrat e njëhershme që nuk kanë qenë të parapara në buxhetin fillestar dhe ato janë të hyrat nga liberalizimi i tregut të telefonisë mobile (licencat për 3G dhe 4G), nga Agjencioni i Privatizimit. Janë marrë parasysh implikimet që rrjedhin për faljen e borxheve.

Ilir Deda - nëse prej Agjencisë së Privatizimi janë paraparë të hyra prej 37 milion euro, pse tani me rishikim është propozuar 7 milion euro?

Agim Krasniqi sa i përket të hyrave nga AKP-ja ne i kemi planifikuar ato të hyra që janë të sqaruara ligjërisht dhe që konsiderohen të hyra të sigurta.

Kryetari të hyrat e planifikuar nga Agjencia e Privatizimit për këtë vit dhe në vitet në vazhdim është planifikim i gabuar, për arsyes se ligji për AKP, përcakton qartë se mjetet pas likuidimit shkojnë për projekte kapitale në bazë të propozimit të qeverisë dhe miratimit të Kuvendit dhe janë pjesë e shtesë e ligjit të buxhetit. Tek financimi i brendshëm është një ndryshim i madh krahasuar me buxhetin fillestar?

Safete Hadergjona - sa i përket të hyrave nga dividenda, a mundet të inkasohen 30 milion euro siç janë planifikuar?

Agim Krasniqi në tabelën 1, tek financimi i njëhershëm janë mjete që planifikohen me u marrë prej AKP-së. Tjetër ndryshim është rritja e të hyrave nga tantiema për 4 milion euro. Të hyrat nga dividenda ka qenë kështu e planifikuara me buxhetin fillestar dhe planifikohen të realizohen nga PTK. Pjesa tjetër

e të hyrave ka mbetur ashtu siç ka qenë. Shpenzimet totale janë 1,664 miliard euro në harmoni me rregullën fiskale prej 2%. Prej tyre 33% janë paga dhe mëditje, 13% mallra dhe shërbime, 26% subvencione dhe transfere dhe 28% investime kapitale. Për shkak të rishikimit të të hyrave, kursimet janë 48.6 milion euro. Nga këto kursime, 25 milion euro janë paga dhe mëditje, 10.6 milion euro në mallra dhe shërbime dhe 12 milion euro në subvencione e transfero. Pavarësisht shkurtimeve, ne kemi arritur të sigurojmë pagesën e pagave dhe mëditjeve, pagesën e përvojës së punës, kemi ruajtur furnizimin për barnat dhe rastet për trajtim jashtë vendit, kemi ruajtur shpenzimet për institucionet e arsimit, shëndetësisë, drejtësisë, sigurisë e institucionet tjera. Kemi bërë rregullime të brendshme dhe nuk kemi lejuar të ndryshojmë strukturën e buxhetit dhe ruajtjen e shpenzimeve kapitale. Nuk ka ndarje të reja për asnjë organizatë buxhetore. Tek buxheti i FSK-së nuk kemi ndërhyrë fare. Tek financimi është ndryshim financimi nga i brendshëm në të jashtëm. Bilanci bankar në bazë të një rregulli që kemi dhe kredi që do të merret nga FMN, duhet me qenë 4.5 e GDP-së dhe për këtë arsye është rritur në 210,5 milion euro.

Safete Hadergjonaj nuk më pëlqen një mënyrë e trajtimit të rishikimit të buxhetit. Sot e kam marrë materialin dhe nuk është e arsyeshme ne si komision të merremi me rishikimin e buxhetit në mënyrë kaq të nxituar. Të paktën, një ditë përpara ta kishim marrë një njoftim që materialin e kemi në kutia dhe që do ta shqyrtojmë me procedurë të përshpejtuar sot. Nuk kemi pas mundësi të shohim se çfarë ka brenda dokumentit të buxhetit dhe nuk po e kuptojmë nxitimin, nuk është situatë e jashtëzakonshme. Qeveria i ka ditur afatet në bazë të marrëveshjes me FMN-në dhe është dashur më herët të procedohet në Kuvend dokumenti.

Kryetari ne e kemi futur këtë pikë plotësuese, përmes procedurës së rregullt dhe votimit në fillimit të hapjes së mbledhjes. Arseja pse e kemi futur për shqyrtim në parim sot, për shkak të marrëveshjes me FMN-në që duhet përmbajtur dhe nevojës që të kemi më shumë kohë si komision funksional në mes dy leximeve, ku edhe jepet kontributi më i madh.

Besa Gaxherri ne e kemi votuar unanimisht në fillim të mbledhjes për futjen e kësaj pike për shqyrtim për sot, për shkak të rëndësisë që ka dhe kemi mjaftë kohë për shqyrtim.

Pas diskutimeve dhe propozimeve, Kryetari konstatoi se shtatë vota Për, një Abstenim dhe asnjë Kundër, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R e k o m a n d i m

I rekomandohet Kuvendit, të miratojë në parim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.05/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2015.

Mbledhja përfundoi në ora 13:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Naser Osmani